



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:052991

Datë: 10.05.2024

Numri i dokumentit: 05670577

P.nr.23/2024

Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Sadri Krasniqi, me bashkëpunëtorin profesional Ali Kryeziu, duke vendosur sipas detyrës zyrtare në çështjen penale kundër të akuzuarit M. M. nga, për shkak të veprës penale: Vjedhje nga neni 313 parag. 1, të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.222/2024, të datës 09.02.2024 dhe Marrëveshjes për zgjidhjen e ndërmjetësuar me nr. ND.10/2024 të datës 03.05.2024, më datë 10.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET Marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar me nr. ND.10/2024 të datës 03.05.2024, e lidhur ndërmjet të dëmtuarit S. S. nga dhe të akuzuarit M. M. nga, përkitazi me Aktakuzën PP.II.nr.222/2024, të datës 09.02.2024.

II. H U D H E T aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.222/2024, të datës 09.02.2024 dhe **PUSHOHET** procedura penale ndaj të akuzuarit M. M., i lindur më nga, me nr. personal për shkak të veprës penale: Vjedhje nga neni 313 parag. 1, të KPRK-së, *pasi që në mes palëve është arritur marrëveshja në procedurë të ndërmjetësimit.*

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.222/2024, të datës 09.02.2024, ka propozuar që ndaj të akuzuarit M.M. nga fsh., të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprës penale: Vjedhe nga neni 313 parag. 2, të KPRK-së, të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe pas vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës konstatoi se aktakuza është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtimin fillestar kundër të pandehurit për datë 30.04.2024, në të cilën seancë gjyqësore prezantonin, Prokurorja e shtetit, i pandehuri M. M. dhe i dëmtuari S.S.. Në fillim të kësaj seance, i pandehuri i propozon gjykatës që seanca gjyqësore të shtyhet për kohë të pacaktuar dhe kjo çështje penale ndaj tij të dërgohet për zgjidhje me procedurë të ndërmjetësimit, të cilin propozim e për krahi i dëmtuari dhe prokurorja e shtetit.

Gjykata duke vepruar sipas propozimit të pandehurit, më datën 30.04.2024, lëndën i ka dërguar për procedurë të mëtutjeshme Referentit për ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Gjilan-dega në Kamenicë.

Referenti për ndërmjetësim më dat.03.05.2024, e njofton Gjykatën se lidhur me çështjen penale P.nr.23/2024, më 03.05.2024, pranë kësaj Gjykate, në procedurën e ndërmjetësimit është lidhur Marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar me nr. ND.10/2024, në mes të pandehurit M.M. dhe të dëmtuarit S.S..

Gjykata, pas shikimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, konstatoi se lidhur me këtë çështje penale duhet hedhur aktakuzën e lartcekur e Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, si dhe pushoi procedurën penale ndaj të pandehurit M.M., ngase më datë 03.05.2024 në mes palëve është arritur marrëveshja në procedurë të ndërmjetësimit.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata, duke u bazuar në nenin 229, paragrafi 4, të Kodit të Procedurës Penale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË –
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2024:052991, 10.05.2024

Gj y q t a r i,

Sadri Krasniqi, d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 3 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2024:052991
Datë: 10.05.2024
Numri i dokumentit: 05670577